

**VENDIM**  
**Nr. 133, datë 7.6.2021**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN MAJ 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 87/6 prot., datë 4.6.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 5698 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin maj 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kWh.

- Sasia e energjisë elektrike të prokuruar në treg të parregulluar është 1,440 mwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s, për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

| Çmimi i FMF-së për muajin Maj 2021                    |                                                                                                    |                     |                      |       |
|-------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|----------------------|-------|
| Maj 2021                                              |                                                                                                    | Aplikimi FSHU sh.a. | Përllogaritjet e ERE |       |
|                                                       |                                                                                                    | Njësia              | Çmimi                | Çmimi |
| CBEt                                                  | Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me pëspërësi | Leke/kWh            | 6.256                | 6.256 |
| Pr                                                    | Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)                                         | Leke/kWh            | 0.19                 | 0.19  |
|                                                       | Çmimi mesatar i blerjes në përdorim relevant                                                       | Leke/kWh            | 6.44                 | 6.44  |
| CA                                                    | Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                                         | Leke/kWh            | 1.79                 | 1.79  |
| TRr                                                   | Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                                     | Leke/kWh            | 0.75                 | 0.75  |
| TSHt                                                  | Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes                                                     | Leke/kWh            | 1.50                 | 1.50  |
| Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA |                                                                                                    | Leke/kWh            | 10.48                | 10.48 |

Për sa përcaktuar, për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021, të jetë 10.48 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, prej 10.48 lekë/kwh, për muajin maj 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**